



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 41 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, si dhe duke iu referuar konkursit të shpallur publik të dt. **08.10.2014**, Njësia e personelit të Komunës së Prishtinës:

N J O F T O N

Se Komisioni përzgjedhës i shërbimit civil (KPSHC) gjatë shqyrtimit të aplikacioneve ka verifikuar se gjithsej **10** kandidatë i kanë plotësuar kushtet për t'i ftuar në testin me **shkrim** lidhur me pozitën - **Zyrtar i lartë çështje juridike**, në kuadër të **Drejtorisë së Arsimit**.

Ndërsa, pas realizimit të testit me shkrim, dhe pas verifikimit të rezultatit nga ana e KPSHC, u konstatua se kandidatët e cekur si më poshtë nuk kanë rezultuar si të suksesshëm, ngaqë në testin me shkrim nuk kanë arritur minimumin prej 50 % të pikëve të caktuara, konform nenit 36 paragrafi 2 të Rregullores nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe si kusht i domosdoshëm për t'u ftuar në intervistën me gojë.

1. **Besianë Gashi - 47 pikë**
2. **Ilirjana Statovci- 41 pikë**
3. **Rrahim Ademi -49 pikë**
4. **Rukije Jashanica - 39 pikë**
5. **Mirsim Gashi - 48 pikë.**

Propozimi i KPSHC-së për emërimin e kandidatit:

HYZRI BUNJAKU, në pozitën- **Zyrtar i lartë çështje juridike**, i vlerësuar me gjithsej **65.4 pikë**, është miratuar nga Kryetari i Komunës, si udhëheqës më i lartë administrativ, pa ndonjë vërejtje.

Andaj, në përputhje me nenin 41 paragrafi 1 të Rregullores nr. 02/2012 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, akti i emërimit do të lëshohet brenda afatit prej 30 ditësh . Ndërkaq, sipas raportit përfundimtar të KPSHC, kandidatët tjerë të renditur si më poshtë, pas testit me shkrim dhe intervistes me gojë kanë arritur këto pikë:

1. **Valbona Hajredinaj - 63.6 pikë**
2. **Ilirjana Metaj-Doçi - 55.2 pikë**
3. **Lirie Kreyeziu - 50.6 pikë**

Ndërsa kandidati **Petrit Jakupi** në testin me shkrim ka arritur **54 pikë** por nuk ka qenë prezent në intervistën me gojë.

PRISHTINË,

NR. 031 - 19541

DT.22.01.2015



Drejtori i Drejtorisë së Administratës
Muhedin Nushi

28-01-2015